



Në bazë të Nenit 10 të Ligjit për Qytetin e Shkupit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/04 dhe 158/11), dhe në përputhje me Programin për aktivitetet e Qytetit të Shkupit nga fusha e arsimit të mesëm në vitin 2024 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 06/24 dhe 12/24) dhe Nenit 2 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare të dedikuara për realizimin e aktiviteteve projektuese të shoqatave, fondacioneve dhe persona të tjerë juridikë nga fusha e arsimit të mesëm me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2024 me nr. 08-3501/1 të datës 01.04.2024, Qyteti i Shkupit shpall

**Thirrje publike
për ndarjen e mjeteve për realizimin e aktiviteteve projektuese
nga fusha e arsimit të mesëm me interes për Qytetin e Shkupit
për vitin 2024**

1. Lëndë e Thirrjes publike

1.1 Lëndë e Thirrjes Publike është mbledhja e ofertave për mbështetje financiare të aktiviteteve projektuese të shoqatave, fondacioneve dhe personave të tjerë juridikë që punojnë në fushën e arsimit të mesëm (në tekstin e mëtejshëm: Organizatat).

1.2 Aktivitetet projektuese do të mbështeten me mjete nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2024 në vlerë të përgjithshme prej 350.000 denarë, dhe në përputhje me Programin për aktivitetet e Qytetit të Shkupit në fushën e arsimit të mesëm në vitin 2024 si dhe kriteret dhe prioritetet e dhëna në këtë Thirrje publike.

1.3 Afati për depozitimim e aplikimeve është 14 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në ueb faqen e Qytetit të Shkupit.

2. E drejta për pjesëmarrje

2.1 Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë shoqata, fondacione dhe persona të tjerë juridikë.

3. Lloji i projekteve që do të mbështeten

3.1 Mjetet nga Buxheti i Qytetit të Shkupit do të përdoren për financimin e aktiviteteve projektuese të shoqatave, fondacioneve dhe subjekteve tjera juridike përmes granteve për projekte që do të realizohen në shkollat e mesme nën kompetencat e Qytetit të Shkupit, të orientuara në prioritetet e mëposhtme:

- Avancimi i shkrim-leximit dixhital të të gjithë anëtarëve të komuniteteve shkolllore;

- Mbështetje psiko-sociale për anëtarët e komunitetit të shkollës për ballafaqimin me dhunën e bashkëmoshatarëve dhe dhunën kibernetike;
- Përmirësimi i mjedisit nëpërmjet ndërgjegjësimit të nxënësve të shkollave të mesme për përgjegjësinë personale në ruajtjen e mjedisi jetësor të pastër dhe të shëndetshëm;
- Hulumtimi dhe promovimi i barazisë gjinore, të drejtave të nxënësve, lirive dhe zhvillimi i krijimtarisë së nxënësve të shkollave të mesme;
- Organizimi i manifestimeve në të cilat do të prezantohen arritjet e shkollës, do të promovohen nxënësit dhe mësuesit më të mirë dhe do të prezantohen rezultatet e aktiviteteve edukative-arsimore para publikut të gjerë.

4. Kritere themelore organizative

4.1 Kriteret themelore organizative që duhet të plotësojnë shoqatat, fondacionet dhe personat e tjerë juridikë pjesëmarrës në këtë thirrje janë:

- Të jenë regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup;
- Të kenë vërtetim nga banka për llogari aktive transaksioni.

5. Vlerësimi i cilësisë së projekteve

5.1 Vlerësimi i cilësisë së projekteve të shoqatave dhe fondacioneve dhe personave të tjerë juridikë të cilët përmbushin kriteret themelore organizative, do të realizohet në bazë të këtyre kriterëve të përgjithshme programore:

Fusha	Pikë maksimale
1. Struktura organizative dhe resurset	30
1.1 Vlerësimi i cilësisë së strukturës organizative për realizimin e projektit (të punësuar, vullnetarë aktivë, persona të angazhuar me honorar)	10
1.2 Ekspertë të cilët marrin pjesë në zbatimin e projektit	10
1.3 A disponon shoqata, fondacioni, dhe personat e tjerë juridikë me ambient për zyrë dhe pajisje teknike për realizimin e projektit	10
2. Financimi i përbashkët i projektit	20
2.1 A siguron shoqata, fondacioni dhe personat e tjerë juridikë më shumë se 15 % të pjesëmarrjes së vet gjatë realizimit të projektit	10
2.2 A është real plani financiar i propozuar (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive/pozicioneve korrespondon me çmimet e tregut)	
3. Cilësia e projektit	40
3.1 Sa do të kontribuojë qëllimi i përgjithshëm i projektit në realizimin e prioriteteve të përcaktuara, sa është i	10

qartë dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate	
3.2 Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara në propozim-projekt	10
3.3. Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera	10
3.4. A është plani i realizimit të projektit i qartë dhe i realizueshëm	10

5.2 Numri maksimal i pikëve që mund të marrë aplikanti është 90 pikë. Secila fushë nga kriteret e përgjithshme, do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, që nënkupton: 1 - jo, 5 - pjesërisht dhe 10 - po.

6. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

6.1 Për ndarjen e mjeteve financiare dhe konfirmimin se janë plotësuar kriteret për pjesëmarrje në Thirrjen Publike, aplikanti është i detyruar të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- **aplikim** i plotësuar në kompjuter për mbështetje financiare të aplikantit, i nënshkruar dhe i vërtetuar nga personi i autorizuar (i aksesueshëm në ueb faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- **formular** i projekt-propozimit i plotësuar në kompjuter (i aksesueshëm në ueb faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- kopje e aktvendimit për regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- kopje e statusit aktual të aplikantit jo më e vjetër se 6 muaj e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- numri i telefonit të kontaktit, adresa dhe adresa e-mail e aplikantit;
- vërtetim nga banka për llogari aktive transaksioni;
- vërtetim për tatime të paguara lëshuar nga organet tatimore;
- vërtetim për shlyerjen e detyrimeve ndaj Qytetit të Shkupit (tatime, taksa komunale);
- deklaratë se për projekt propozimin e bashkangjitur nuk janë marrë mjete financiare nga Buxheti i Qytetit të Shkupit në vitin aktual dhe i njëjti nuk do të financohet në mënyrë të dyfishtë nga Buxheti i Qytetit të Shkupit deri në përfundimin e tij.

6.2. Për pjesëmarrje në Thirrjen Publike, aplikanti mund të depozitojë edhe dokumentacion shtesë:

- buxhet vjetor i aplikantit për vitin në vijim,
- biografi profesionale e ekspertëve të cilët do të angazhohen në realizimin e projektit,
- listë referimi ose dëshmi (për shembull: kontratë e nënshkruar) për të paktën 2 projekte të realizuara nga fusha për të cilën aplikohet,

- më së paku dy rekomandime/referenca nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme, dhe
- përkrahje me shkrim nga organizata ose institucione të cilat janë paraqitur si pjesëmarrës në realizimin e projektit.

6.3 Aplikantët **NUK mund** të depozitojnë më shumë se një aplikim për mbështetje financiare për këtë Thirrje Publike.

6.4 Në propozim – projektin e depozituar, shoqatat, fondacionet dhe personat juridikë **duhet të përcaktohen për një nga prioritetet e cituara në pikën 3 të Thirrjes publike**, në suazat e së cilës do ta realizojnë projektin.

6.5 Aktivitetet e parashikuara në propozim-projektet e shoqatave, fondacioneve dhe personave të tjerë juridikë, duhet të dedikohen **vetëm për 23 shkollat e mesme nën kompetencat e Qytetit të Shkupit**, dhe në kornizën kohore: shtator, tetor, nëntor deri më 5 dhjetor 2024.

7. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

7.1 Për të përcaktuar përmbushjen e kriterëve për ndarjen e mjeteve financiare, kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komisionin për realizimin e Thirrjes publike për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve projektuese në fushën e arsimit të mesëm me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

7.2 Projektet të cilat pas vlerësimit nga Komisioni do të vlerësohen me më pak se 55 pikë nuk do të kualifikohen për të marrë mbështetje financiare nga Qyteti i Shkupit.

7.3 Aplikantët, projektet e të cilëve nuk do të mbështeten financiarisht, do të njoftohen me shkrim nga Komisioni.

7.4 Propozimi për ndarjen e mjeteve financiare nënshkruhet nga kryetari i Komisionit dhe depozitohet pranë kryetarit të Qytetit. Kryetari i Qytetit të Shkupit në afat prej 15 ditësh nga dita e depozitimit të propozimit do të miratojë Aktvendimin për ndarjen e mjeteve financiare. Shfrytëzimi i mjeteve të ndara do të rregullohet në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar me Qytetin e Shkupit.

7.5 Aplikantët, projekt-propozimet e të cilëve do të përzgjidhen për financim, nuk do të kenë të drejtë të ndryshojnë aktivitetet dhe afatin kohor për realizimin e tyre, të përshkruara në projektin me të cilin kanë aplikuar, përveç rastit me pëlqimin paraprak me shkrim nga Qyteti i Shkupit.

8. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

8.1 Afati për depozitimin e aplikimeve është 14 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në ueb faqen e Qytetit të Shkupit.

8.2 Dokumentacioni i nevojshëm për pjesëmarrje në thirrje dërgohet me postë në adresën: Qyteti i Shkupit, Sektori i Arsimit, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup ose në arkivin e Qytetit të Shkupit në barakën nr.16. Aplikimet dhe dokumentet depozitohen në zarf të mbyllur me shënimin: Sektori i Arsimit – Aplikim për Thirrje Publike.

8.3 Aplikantët do të njoftohen për rezultatet në një afat kohor prej 10 ditësh nga dita e miratimit të Aktvendimit për ndarjen e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2024, të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave, fondacioneve dhe personave të tjerë juridikë.

8.4 Vërejtje: Aplikimet me dokumentacion të pakompletuar ose të depozituar pas përfundimit të afatit të parashikuar, nuk do të shqyrtohen! Bashkëngjitjet e depozituara nuk kthehen.

Aplikimi për realizimin dhe financimin e projekteve nga fusha e arsimit, dhe Formulari, mund të shkarkohen nga faqja e internetit e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk në pjesën Shpallje, konkurse, evenimente – Thirrje publike.

Për informacione shtesë:

Pyetjet për sqarime mund të dërgohen në e-mail adresën e Maja Atanasijeviq - Maja.Atanasijevik@skopje.gov.mk, si dhe në numrin e telefonit të Sektorit të arsimit 02/ 3297-317.